



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
AGJENCIA E ADMINISTRIMIT TË PASURIVE TË SEKUESTRUARA DHE TË KONFISKUARA
NJËSIA E ANKANDIT

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Për: Personin Juridik **ÇEKREZI METAL**, me nipt **K91602003E**, me adresë: **Tirane Vaqarr VAQARR Truall me nr.pasurie 291/1, zona kadastrale 3712, Vaqar, me adminsitrator Z.Andjol CANI.**

* * *

Procedura e ankandit: *Procedurë e hapur*, Buletini i Njoftimeve Publike nr.57 datë 06 Tetor 2025 dhe Buletini e Njoftimeve Publike nr.63 datë 27 tetor 2025.

Përshkrim i shkurtër i procedurës së ankandit dhe objektit të tij:

<i>Nr.</i>	<i>EMËRTIMI</i>	<i>Vlera fillestare lekë (pa TVSH)</i>
1	<i>Pajisje, makineri dhe automjete</i>	<i>21 723 029</i>

Pajisjet dhe makineritë janë të vendosura në zonën e Kalivaçit, Tepelenë, konkretisht në kantierin e ndërtimit të hidrocentralit Kalivaç. Këto pasuri objekt ankandi janë pasuri të shoqërisë “Energji-Kalivaç” e cila është një shoqëri e sekuestruar. Brënda këtij kantieri ndodhen një sërë pajisjesh dhe makinerish që variojnë nga pajisje zyre dhe kancelarie deri te makineritë e rënda, përfshirë impiantin e prodhimit të betonit dhe mjete të ndryshme transporti. Këto mjete dhe pajisje nuk janë përdorur apo mirëmbajtur për një periudhë të gjatë kohe, që përkon me më shumë se një dekadë, çka ka ndikuar ndjeshëm në amortizimin e tyre të përgjithshëm dhe paraqesin një gjendje të rënduar fizike dhe teknike.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *Buletini i /njoftimeve Publike nr. nr.57 datë 06 Tetor 2025 dhe Buletininn e Njoftimeve Publike nr.63 datë 27 tetor 2025*

Njoftojme se, kane qene pjesemarres ne procedure keta ofertues me vlerat perkatese te ofruara:

1. Cekrezi-Metal shpk

K91602003E

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera 21 723 029 (njëzet e një million e shtatëqind e njëzet e tre mijë e njëzet e nëntë) lekë pa tvsh.
(me numra dhe fjale)

2. Shijaku shpk

J64102272V

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera 21 723 029 (njëzet e një million e shtatëqind e njëzet e tre mijë e njëzet e nëntë) lekë pa tvsh
(me numra dhe fjale)

3. BOE "Inerte Exrepes" shpk dhe "Nexhmije Hysa" PF K72113012U dhe L91707008E

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

(Bashkuar sipas marrëveshjes së bashkëpunimit me nr.rep.4587, nr.kol.1438 dtë 31.10.2025, me përfaqesues ligjor Z.Kastriot Begaj sipas prokurës së posaçme me nr.rep.4588, nr.kol.1439, datë 31.10.2025)

Vlera 21 800 000 (njëzet e një million e tetëqind mijë) lekë pa tvsh.
(me numra dhe fjale)

4. BOE "Alb Building" shpk dhe Larti" shpk"

J69102508C dhe J94316024A

(Bashkuar sipas kontratës së bashkëpunimit me nr.rep.6682, nr.kol.3338, datë 31.10.2025, përfaqësues ligjor Z.Odhise Bresha, sipas prokurës së posaçme me nr.rep.6683, nr.kol. 3339, datë 31.10.2025)

Vlera 21 723 029 (njëzet e një million e shtatëqind e njëzet e tre mijë e njëzet e nëntë) lekë pa tvsh.
(me numra dhe fjale)

Jane skualifikuar ofertuesit e meposhtem:

1 .BOE "Inerte Exrepes" shpk dhe "Nexhmije Hysa" PF K72113012U dhe L91707008E

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

(Bashkuar sipas marrëveshjes së bashkëpunimit me nr.rep.4587, nr.kol.1438 dtë 31.10.2025, me përfaqesues ligjor Z.Kastriot Begaj sipas prokurës së posaçme me nr.rep.4588, nr.kol.1439, datë 31.10.2025)

Vlera 21 800 000 (njëzet e një million e tetëqind mijë) lekë pa tvsh.
(me numra dhe fjale)

2. BOE "Alb Building" shpk dhe Larti" shpk"

J69102508C dhe J94316024A

(Bashkuar sipas kontratës së bashkëpunimit me nr.rep.6682, nr.kol.3338, datë 31.10.2025, përfaqësues ligjor Z.Odhise Bresha, sipas prokurës së posaçme me nr.rep.6683, nr.kol. 3339, datë 31.10.2025)

Vlera 21 723 029 (njëzet e një million e shtatëqind e njëzet e tre mijë e njëzet e nëntë) lekë pa tvsh.
(me numra dhe fjale)

Perkatesisht per arsyet e meposhtme:

1. BOE "Inerte Exrepes" shpk dhe "Nexhmije Hysa" PF

Në vijim të dokumentacionit ligjor të dorëzuar së bashku me ofertën ekonomike për kriteret e përgjithshme dhe të vecanta të përcaktuara në DSA, oferta ekonomike vlerësohet e pavlefshme për arsye të mos plotësimit të kriterëve të përcaktuara nga ASH në DSA lidhur me:

1. Fletët e ofertës nuk janë të numerizuara sipas përcaktive në DSA "Hartimi i Ofertës" pika 3.7 ku citohet se;

3.7 Origjinali i ofertës duhet të shtypet ose të shkruhet me bojë që nuk fshihet. Të gjitha fletët e ofertës duhet të lidhen së bashku dhe të numerizohen. Të gjitha fletët e ofertës, përveç literaturës së pandryshueshme e të printuar duhet të pajisen me iniciale ose të nënshkruhen nga Personi (-at) e autorizuar.

Oferta e administruar nga BOE nuk është e numerizuar e as firmosur në cdo fletë nga personi i autorizuar, vetëm formulari i ofertës i administruar nga BOE është i numerizuar.

2. Ofertës ekonomike i mungon Formulari i cmimit i bazuar në gërmën c të pikës 5 të nenit 36 të Ligjit Nr.9874 datë 14.02.2008 "Për Ankandin Publik", ku citohet se.

5. Autoriteti shitës nuk e pranon një ofertë:

- a) kur ofertuesi nuk është i kualifikuar;
- b) kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, të bërë sipas 21 pikës 2 të këtij neni;
- c) kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e ankandit;
- ç) në rastet e parashikuara në nenin 15 të këtij ligji.

Mungesa e dokumentacionit (formularit të çmimit) e bën të pamundur për autoritetin shitës të reflektojë vlerën totale të ofertës në përpjestim me çmimin, vlerën për çdo artikull objekt i këtij ankand.

Sa më sipër ky kriter vlerësohet i paplotësuar.

2. Për kriterin e përcaktuar në pikën 5 tek Kriteret e Vecanta të Kualifikimit si më poshtë vijon është kërkuar nga ASH:

5. Ofertuesi për kryerjen e proceseve duhet të disponojë makineritë si mëposhtë:

- a. Rimorkiator (për transportimin e mjeteve të rënda) 1 copë;
- b. Vinxh (për ngritjen e mjeteve që nuk mund të lëvizin vetë për shkak të amortizimit dhe mallrave të tjerë që janë të palëvizshëm) 1 copë;

c.Kamion për ngarkim skrap 1 copë;

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, duhet të paraqitet:

- a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit;
- b) leje qarkullimi;
- c) çertifikatën e kontrollit teknik;
- d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm);
- e) foto për secilin mjet të deklaruar, ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit;
- f) çertifikatën për transport mallrash brenda vendit, (e vlefshme);
- g) licencë e shoqërisë për transport;

a)/1 Për mjetet e siguruara me qira duhet të paraqitet:

- a) dokumenti që vërteton regjistrimin e tij;
 - b) leje qarkullimi;
 - c) çertifikatën e kontrollit teknik,
 - d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm);
 - e) foto për secilin mjet të deklaruar, ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit;
 - f) çertifikatën për transport mallrash brenda vendit, (e vlefshme);
 - g) Mjetet të shoqërohen me kontratën përkatëse të qirasë/, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij i ankandit ;
- Bashkimi i operatorëve për këtë kriter kanë administruar disa nga dokumentacionet e kërkuar sipas kërkesave në gjermën a) dhe b) për mjetin e kërkuar rimorkiator por mungon foto dhe licenca e shoqërisë për transport, po ashtu edhe për kamionin për skrap mungon licenca e shoqërisë për transport, ndërsa për mjetin e kërkuar te tipit vinch Boe nuk ka administruar asnjë dokumentacion provues që ka një mjet të tillë apo një kontratë qiraje që provon plotësimin e këtij kriteri.

Për sa mësipër ky kriter vlerësohet i paplotësuar.

2. BOE “Alb Building” shpk dhe Larti” shpk”

Në vijim të dokumentacionit ligjor të dorëzuar së bashku me ofertën ekonomike për kriteret e përgjithshme dhe të vecanta të përcaktuara në DSA, oferta ekonomike vlerësohet e pavlefshme për arsye ku përcaktohet që formulari i ofertës ekonomike duhet të dorëzohet në zarf të mbyllur, po ashtu oferta ekonomike vlerësohet e pavlefshme për mos plotësimi të kriterëve të përcaktuara nga ASH në DSA lidhur me.

1.Oferta ekonomike është dorëzuar në kundërshtim me përcaktimet e VKM-së „Nr.1719, datë 17.12.2008 “Për miratimin e rregullave të ankandit publik” ndryshuar, Kreu V pika 5.2 Dorëzimi i ofertave, paragrafi b ku citohet.

b) Në rastin e procedurës së hapur, zarfi i mbyllur duhet të përmbajë dokumentet kualifikuese të kandidatit/ofertuesit dhe ofertën ekonomike. Në rastin e procedurës me përzgjedhje të blerësve apo me negociim, zarfi duhet të përmbajë vetëm dokumentet e kualifikimit, siç parashikohet në njoftimin e ankandit. Ofertuesit/kandidatët duhet ta dorëzojnë ofertën origjinale të mbyllur në një zarf. Zarfi duhet të paraqitet sipas përcaktimeve të dhëna në dokumentet standarde të ankandit.

1. Ofertës ekonomike i mungo Formulari i cmimit i bazuar në gërmën c të pikës 5 të nenit 36 të ligjit Nr.9874 date 14.02.2008 ‘Për Ankandin Publik’, ku citohet se;

5. Autoriteti shitës nuk e pranon një ofertë:

- a) kur ofertuesi nuk është i kualifikuar;
- b) kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, të bërë sipas 21 pikës 2 të këtij neni;
- c) kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e ankandit;
- ç) në rastet e parashikuara në nenin 15 të këtij ligji.

Mungesa e dokumentacionit(formularit tëcmimit) e bën të pamundur për autoritetin shitës të reflektojë vlerën totale të ofertës në përpjestim me cmimin, vlerën për cdo artikull objekt i këtij ankand.

Sa më sipër ky kriter vlerësohet i paplotësuar.

2. Për kriterin e vendosur në pikën 4 tek “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit”,

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, ofertuesi duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, ofertuesi duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

BOE/ ALB-Building dhe Larti shpk nuk kanë arritur të justifikojnë me anë të dokumentacionit të dorëzuar punën e ngjashme në sektorin publik dhe privat sipas kërkesave të përcaktuara në pikën 4 tek kriteret e vecanta të kualifikimit. Boe ka dorëzuar dokumentacion që verteton që ka qënë pjesmarrës në procedura ankandi publik, por objekti i tyre nuk është i ngjashëm me objektin e ankandit që po zhvillohet nga Autoriteti ynë shitës. Boe ka paraqitur dokumentacion mbi ankand të zhvilluar në të cilin blerësi është shoqëria Alb Building me objekt tulla zjarrduruese dhe dokumentacioni i ankandit tjetër që pjesëmarrës në ankand është po shoqëria Alb-Building me

objekt pasuri e paluajtshme. Shihet qartë nga dokumentacioni i dorëzuar që ky kriter nuk është i plotësuar por gjithashtu kriteri duhet të plotësohet në përporsion të % që të dy operatorët pjesëmarrës kanë dakortësuar në marrëveshjen e bashkëpunimit.

Sa më sipër ky kriter vlerësohet i paplotësuar.

3. Për kriterin e vendosur në pikën 5 gërma a tëk Kriteret e vecanta të Kualifikimit:

5. Ofertuesi për kryerjen e proceseve duhet të disponojë makineritë si mëposhtë:

a. Rimorkiator (për transportimin e mjeteve të rënda) 1 copë;

b) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, duhet të paraqitet:

a) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit;

b) leje qarkullimi;

c) certifikatën e kontrollit teknik;

d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm);

e) foto për secilin mjet të deklaruar, ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit;

f) certifikatën për transport mallrash brenda vendit, (e vlefshme);

g) licencë e shoqërisë për transport;

a)/1 Për mjetet e siguruara me qira duhet të paraqitet:

a) dokumenti që vërteton regjistrimin e tij;

b) leje qarkullimi;

c) certifikatën e kontrollit teknik,

d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm);

e) foto për secilin mjet të deklaruar, ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit;

f) certifikatën për transport mallrash brenda vendit, (e vlefshme);

g) Mjetet të shoqërohen me kontratën përkatëse të qirasë/, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij i ankandit ;

Për këtë kriter BOE ALB-Building dhe Larti shpk në dokumentacionin e dorëzuar për plotësimin e pikës 5\ a në të cilin kërkohet disponimi i mjetit rimorkiator, për plotësimin e kësaj pike është investuar shoqëria Larti shpk duke sjellë dokumentacionin sipas kërkesave të përcaktuara nga ASH por e pa shoqëruar me licensën e shoqërisë për transport.

Sa më sipër ky kriter vlerësohet i paplotësuar.

4. Për kriterin e vendosur nga ASH me shpikjen nr. 4766/15 Prot., datë 17.10.2025 “Leje Mjedisore të tipit B”, kodi III.1.B, kategoria “Për ndikimin në mjedis”, për veprimtarinë; Magazinim/Grumbullim i hekurishteve/skrapeve të metalit që nuk përmbajnë materiale të

rrezikshme. Leja mjedisore të jetë e shoqëruar me aktin e miratimit nga Ministria e Mjedisit për zbatimin e kërkesave të legjislacionit mjedisor në fuqi.

Për këtë kriter janë administruar nga BOE ALB-Building dhe Larti shpk licensë Kodi III.2.B kategoria, “Shërbime ekspertize dhe ose profesionale lidhur me ndikim në mjedis” për veprimtarinë “Grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim dhe asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme(skrap)”, shoqëruar me Aktin e miratimit nga Ministria e Mjedisit me Nr.1314/13 prot., datë 22.02.2013, për subjektin Larti Shpk.

Dokumentacioni i dorëzuar nga Boe për plotësimin e këtij kriteri është i ndryshëm me lejen që ASH ka kërkuar sepse leja e kërkuar nga ASH është për veprimtaritë që ndikojnë në mjedis ndërsa licensa III.2.B është për shërbime profesionale dhe ekspertize teknike që lidhen me mjedisin. Natyra e veprimtarisë së III.1.B rregullon veprimtarinë operative me ndikim në mjedis ndërsa III.2.B licenson subjekte që ofrojnë shërbime të specializuara në fushën e mjedisit.

Sa më sipër ky kriter vlerësohet i paplotësuar.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Person Juridik ÇEKREZI METAL, me nipt K91602003E, oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 23 026 410.74 (njëzet e tre milion e njëzet e gjashtë mijë e katërqind e dhjetë pikë shtatëdhjetë e katër)lekë pa tvsh. është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, Adresa : Rruga Kavajës, Kompleksi “Delijorgji”, Kulla C1, K.1, H.2, Tiranë**, kopjen e nënshkruar të formularit të kontratës dhe të sigurimit të kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të ligjit për prokurimet publike nr.9643 date 20.11.2006

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 10.11.2025.

Ankesa: ka ose jo: PO , procedura është shqyrtuar në KPP.

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë: Sipas Vendimit 213/2026, datë 09.02.2026.